



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302946/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për dhënien e pagesës së verbërisë shtetases Barije Baki Hyseni, e cile ka përfituar "Statusin e të Verbërit".*

Drejtuar: **Z. Qazim SEJDINI**
Kryetarit të Bashkisë

ELBASAN

I nderuar zoti SEJDINI,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja B. H, me objekt: mosdhënien e së drejtës për të përfituar pagesën e verbërisë.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë dhe dokumentacionit bashkangjitur, konstatojmë se me vendimin nr.1757 datë 02.08.2013 të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë, shtetasja B.H ka përfituar "Statusin e të Verbërit", grupi i dytë, për periudhën 02.08.2013-02.08.2014.

Ankueses nuk i është dhënë pagesa mujore që nga lindja e së drejtës për ta përfituar atë dhe kjo i ka krijuar barriera, duke mos përballuar dot nevojat me imediate të jetesës së përditshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj si dhe në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Ju bëjmë me dije për çështjen e pagesës së aftësisë së kufizuar, institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Ministrin të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë lëvrimin e fondeve për dhënien e kësaj pagese.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, na kanë informuar se do të bëhen të gjitha pagesat individuale për personat me aftësi të kufizuara fizike e mendore, persona të verbër, individët para e tetraplegjikë si dhe pagesa e paketës

higjiëno-sanitare për këta të fundit. Siç jeni në dijëni, së fundmi, Këshilli i Ministrave ka aprovuar një fond prej 1.8 miliardë lekësh, me qëllim kryerjen e plotë të pagesës për muajin Dhjetor 2013 dhe më pas gjatë muajit Janar 2014 e në vazhdim do të kryhen të gjitha pagesat e prapambetura.

Por ankuesja nuk ka përfituar as pagesën e muajit Dhjetor 2013.

Sa më lart, me qëllim që kjo shtetase të përfitojë të drejtën e saj ligjore si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Dhënien e pagesës së verbërisë shtetases B. H, e cila ka përfituar “Statusin e të Verbërit”, sipas vendimit nr.1757 datë 02.08.2013 të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë .

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI

